


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2024

Tiranë, më 17 Shtator 2024: Në Gusht 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 22 mld lekë, duke u ulur me -18,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -32,5 %, në krahasim me Korrik 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 69 mld lekë, duke u rritur me 1,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me -19,4 %, në krahasim me Korrik 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 46 mld lekë, duke u rritur me 15,6 %, krahasuar me Gusht 2023 dhe duke u ulur me -11,0 %, në krahasim me Korrik 2024.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë tetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 255 mld lekë, duke u ulur me -14,9 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 595 mld lekë, duke u rritur me 3,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 340 mld lekë, duke u rritur me 22,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Gusht 2024, në uljen e eksporteve prej -18,2 %, kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -10,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,8 pikë përqindje, etj.

Për publikim 17/09/2024

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2024




Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë ulur me -14,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -6,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,6 pikë përqindje, etj. Pozitivisht ka ndikuar grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,1 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Gusht 2024, në rritjen e importeve prej +1,9 %, krahasuar me Gusht 2023, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +0,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,0 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -0,8 pikë përqindje, etj.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2024



Si tetëmujor, importet janë rritur me +3,1 %, krahasuar me tetëmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,9 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje, Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,4 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, etj.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2023 janë: Italia (1,5 %), Kosova (17,4 %), Greqia (43,4 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Gjermania (34,2 %), Kina (46,3 %), Turqia (37,8 %), etj.

Gjatë këtij tetëmujori vendi me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, është: Italia (13,2 %), Kosova (2,3 %), Greqia (24,1 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (28,6 %), SHBA (0,8 %), etj.

Në muajin Gusht 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (2,8 %), Kina (13,0 %), Turqia (22,1 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania (6,5 %), Spanja (40,7 %), Maqedonia e Veriut (28,6 %), etj.

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (17,6 %), Greqia (19,4 %), Gjermania (4,5 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (2,4 %), Kina (1,6 %), Spanja (3,5 %), etj.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 52,1 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 65,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 47,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (22,1 %), Kina (11,2 %), Turqia (8,1 %) dhe Gjermania (6,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 57,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,9 %), Turqia (8,2 %), Kina (8,1 %) dhe Greqia (7,2 %)

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Gusht 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	Janar – Gusht 21	232	37,3	487	29,3	-254	47,8
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	Janar – Gusht 22	328	41,0	607	24,8	-280	54,0
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	Janar – Gusht 23	300	-8,6	577	-5,0	-277	51,9
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	Janar – Gusht 24	255	-14,9	595	3,1	-340	42,9

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Gusht 2024

	Eksporte				Importe			
	Gusht 2023	Gusht2024	Jan, - Gusht 2023	Jan, - Gusht 2024	Gusht 2023	Gusht2024	Jan, - Gusht 2023	Jan, - Gusht 2024
Vendet e BE-së	17.081	14.809	217.991	181.098	31.169	32.819	294.922	305.705
Austri	329	95	2.686	1.647	391	681	4.798	5.259
Gjermani	1.256	1.686	16.066	14.738	4.983	4.658	40.456	42.272
Greqi	2.406	1.361	20.964	15.912	3.932	4.751	37.887	45.243
Itali	8.676	8.545	128.439	111.456	11.367	11.684	128.960	125.893
Spanjë	1.721	263	13.521	7.911	1.763	1.046	9.384	9.055
Kroaci	202	158	3.581	2.914	947	571	5.286	3.294
Të tjera të BE-së	2.491	2.702	32.733	26.521	7.786	9.429	68.152	74.689
Mbretëri e Bashkuar	2.458	71	5.884	1.009	570	578	5.420	6.554
Kinë	813	1.189	5.715	7.352	7.990	9.025	62.585	61.574
Kosovë	3.740	3.091	27.520	26.892	1.116	1.780	7.514	10.694
Maqedonia e Veriut	1.051	831	12.248	9.219	1.274	910	9.107	8.009
Rusi	-	2	8	7	345	278	3.170	2.450
SHBA	457	214	2.956	2.980	1.117	1.332	11.462	12.955
Turqi	196	270	2.650	2.748	5.820	7.104	56.698	66.681
Ukrainë	5	48	1.025	2.501	232	235	2.681	2.930
Zvicër	112	127	3.652	1.690	920	903	9.079	5.454
Të tjera	1.581	1.841	20.008	19.585	17.114	13.956	114.301	111.619
Gjithsej	27.494	22.493	299.657	255.083	67.668	68.920	576.940	594.625

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Gusht 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 2023	Gusht2024	Jan, - Gusht 2023	Jan, - Gusht 2024	Gusht 2023	Gusht2024	Jan, - Gusht 2023	Jan, - Gusht 2024
Gjithsej	27.494	22.493	299.657	255.083	67.668	68.920	576.940	594.625
Ushqime, piqe, duhan	3.050	2.979	38.443	35.059	13.214	14.212	95.686	104.384
Minerale, lëndë djegëse, en. et	8.697	5.961	69.315	50.200	10.102	9.571	67.678	60.761
Produkte kimike dhe plastike	1.261	1.064	10.367	10.544	8.098	8.192	76.614	76.596
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	115	45	1.867	1.371	592	558	9.480	7.876
Prodhime druri dhe letre	659	628	7.507	6.599	2.227	2.176	19.888	19.996
Tekstile dhe këpucë	5.843	4.838	85.386	70.185	5.122	5.500	61.433	56.168
Materiale ndërtimi dhe metale	4.851	4.074	52.100	47.347	8.894	8.206	81.232	83.465
Makinëri, pajisje dhe pj. këmb.	2.306	2.276	26.511	24.618	16.758	17.125	141.451	158.462
Të tjera	712	628	8.161	9.161	2.661	3.379	23.478	26.917

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2024

	Itali		Kosovë		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	128.439	111.456	27.520	26.892	20.964	15.912	16.066	14.738
Ushqim. pije duhan	10.219	9.129	4.568	4.331	3.141	2.872	1.298	1.212
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	6.456	10.258	5.426	5.695	7.570	2.410	5.887	4.271
Produkte kimike dhe plastike	3.926	3.895	2.731	2.807	722	647	37	32
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.752	1.160	7	4	22	146	9	1
Prodhime druri dhe letre	4.374	3.478	814	839	1.188	1.036	76	77
Tekstile dhe këpucë	66.530	52.747	157	112	4.733	5.282	6.439	6.224
Materiale ndërtimi dhe metale	17.386	14.498	11.100	10.769	2.827	2.824	904	694
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	14.171	12.823	1.577	1.436	86	151	1.177	1.945
Të tjera	3.625	3.468	1.139	899	675	544	239	281

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2024

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	128.960	125.893	56.698	66.681	62.585	61.574	37.887	45.243
Ushqim. pije duhan	18.712	21.076	4.002	3.651	1.259	1.153	11.754	12.854
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.533	3.586	7.458	8.203	28	16	3.920	7.213
Produkte kimike dhe plastike	15.659	15.380	8.000	8.110	5.390	5.161	6.391	7.408
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.621	6.040	224	226	595	682	25	120
Prodhime druri dhe letre	4.429	4.005	3.132	3.262	1.333	1.360	2.660	2.719
Tekstile dhe këpucë	28.469	23.743	9.381	7.517	8.262	9.184	3.483	4.196
Materiale ndërtimi dhe metale	17.053	14.873	13.239	19.378	8.895	8.158	5.728	6.016
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	26.892	29.561	8.559	13.347	32.180	30.359	2.633	3.071
Të tjera	5.592	7.630	2.704	2.986	4.642	5.501	1.294	1.647

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Malte, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri